



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:273775
Datë: 08.11.2024
Numri i dokumentit: 06426181

Ac.nr.798-2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konusgevc - kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Nehat Idrizi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit L. T., nga fshati B. Komuna e K., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokat T. R., me seli në P., Rruga “Sh. B.”, pn, kundër të paditurës Komuna e Klinës– Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensim shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtim, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.893/21, të datës 23.11.2022, pas mbajtjes së seancës së kolegjit, me datë 04.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Klinës– Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Dega Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.893/21, të datës 23.11.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.893/21, të datës 23.11.2022, ka vendosur si në vijim: **“APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit L. T., nga fshati B. Komuna e K, DETYROHET e paditura Komuna e Klinës – Drejtoria e Arsimit, që paditësit t’ia paguajë në emër të kompensimit për ushqim - shujtave gjatë ditëve të punës, shumën prej 360.00 euro, për periudhën kohore nga data 14.09.2020 deri me datë 30.06.2021, apo gjithsejtë për 180 ditë pune, si dhe në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit shumën prej 991,20 euro, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datën 30.06.2021, apo gjithsejtë për 708 ditë pune, shuma e përgjithshme në lartësi prej 1351,20 euro, me kamatë ligjore, në lartësi prej 8 % në vit, duke filluar llogaritja e kamatës nga data 06.12.2021, dita e paraqitjes së padisë dhe kërkesëpadisë, në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive, si dhe shpenzimet e kësaj procedure, në shumë prej 124.00 euro (njëqind e njëzet e katër), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga marrja-pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit”**.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të paraparë ligjor, ankesë ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovoj ankesën, ta prishë aktgjykimin dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje ose të refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit, me datë 06.12.2021 ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Klinës– Drejtoria Komunale e Arsimit, lidhur me kompensimin shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, duke pretenduar se padia është e bazuar ne dispozitat e nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, andaj mbi këtë bazë kërkoj nga gjykata aprovimin e të njëjtës në tërësi si të bazuar si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit e të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.893/21, të datës 23.11.2022, me të cilin ka vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ndër tjera ka konstatuar se në mes palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura. Gjykata përmes vërtetimit të lëshuar nga e paditura mbi ditët e prezencës në punë të paditësit lidhur me shpenzimet e ushqimit dhe të udhëtimit vërtetoi faktin se sipas vërtetimit të datës 02.07.2021, paditësi nga data 14.09.2020 e gjerë me datën 30.06.2021, ka realizuar gjithsejtë 180 ditë pune për të cilat kërkon kompensimin e ushqimit ndërsa me vërtetimin me Nr.ref.2021 të datës 02.07.2021, paditësi nga data 18.04.2017, dita kur kontrata kolektive ka hyrë në fuqi e deri me datë 30.06.2021, ka realizuar gjithsejtë 708 ditë pune për të cilat kërkon kompensim për udhëtim, ndërsa me vërtetimin e lëshuar nga Agjensia e udhëtimit “B. R.” me datë 12.07.2021, vërtetohet se paditësi udhëton për çdo ditë të punës nga fshati B. për në qytetin e K..

Detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës dhe kamatëvonesës prej 8% në vit është gjykuar nga Gjykata bazuar nenit 382 të LMD-së, në të cilën dispozitë është përcaktuar se: “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

Ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës, Gjykata e bazoi në nenin 449 dhe 452.1 të LPK-së, duke marr parasysh suksesin e paditëses në kontest, ashtu që e detyroi të paditurën që t’ia kompensoj paditëses shpenzimet në lartësi prej 124.00 euro dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104 euro, kurse në emër të taksës gjyqësore për padi shumë prej 20.00 euro.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, e po ashtu e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore e të autorizuarit të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se mes palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura. Përmes vërtetimit të lëshuar nga e paditura mbi ditët e prezencës në punë të paditësit lidhur me shpenzimet e ushqimit dhe të udhëtimit vërtetoi faktin se sipas vërtetimit të datës 02.07.2021, paditësi nga data 14.09.2020 e gjerë me datën 30.06.2021, ka realizuar gjithsejtë 180 ditë pune për të cilat kërkon kompensimin e ushqimit ndërsa me vërtetimin me Nr.ref... të datës 02.07.2021, paditësi nga data 18.04.2017, dita kur kontrata kolektive ka hyrë në fuqi e deri me datë 30.06.2021, ka realizuar gjithsejtë 708 ditë pune për të cilat kërkon kompensim për udhëtim, ndërsa me vërtetimin e lëshuar nga Agjensia e udhëtimit "B. R." me datë 12.07.2021, vërtetohet se paditësi udhëton për çdo ditë të punës nga fshati B. për në qytetin e K..

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale për arsye se me nenin 90 paragrafin 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: "*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*". Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: "*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes*". Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: "*Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës*". Me paragrafin 5 përcaktohet se: "*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...*".

Me nenin 35 paragrafin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, përcaktohet se: "*Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim*". Me nenin 35 paragrafin 5, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 përcaktohet se: "*Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban*".

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditëses, duke e obliguar të paditurën që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për periudhën kohore prej datës 14.09.2020 deri me datë 30.06.2021, apo gjithsejtë për 180 ditë, ,shumën prej 360.00 dhe që në emër të kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, udhëtimit shumën prej 991,20 euro, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datën 30.06.2021, me të drejtë është bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT),

e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e parashtrimit të kërkesës për shpenzimet e rrugës dhe shpenzimet e ushqimit për ditët në punë, që rrjedhimisht nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko - civil, ndaj paditëses në emër të pagesës për, shpenzimet e rrugës si dhe shpenzimeve të ushqimit – shujtës - udhëtimit gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë është në përputhje të plotë me dispozitën nga neni 382 paragrafët 1 dhe 2 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.798/2023, datë 04.11.2024

Kryetari i Kolegjit- Gjyqtari
Adnan Konushevci